



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 qershor 2021
Nr.ref.:RK 1804/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI81/20

Parashtrues

Arbër Shkreli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 457/2019 të 30 janarit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arbër Shkreli nga fshati Treboviq, komuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga avokati Idriz Ibraj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev. nr.457/2019] të 30 janarit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta)

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 maj 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani (anëtare).
7. Më 25 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrim si dhe i dërgoi asaj një kopje të kërkesës.
8. Më 20 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës

Përmbledhja e fakteve

9. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë i punësuar në KEDS-Distrikti në Pejë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) në pozitën e Punëtorit Fizik në Divizionin e Rrjetit, Departamenti i Sistemit të Operimit, që nga vitin 2009 me kontrata për periudha të caktuara kohore, dhe në bazë të kontratës së fundit nga 1 shtatori 2014 dhe të ndryshuar me aneks Kontratën e 16 janarit 2015.

10. Më 14 dhjetor 2015, punëdhënësi në bazë të Vendimit [nr.10697], e kishte suspenduar nga puna parashtruesin e kërkesës, deri në një vendim tjetër, për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave të punës, të përcaktuara në nenin 6 paragrafi 6.1 nënparagrafi (a), (j), (n) dhe (p) të Kodit Disiplinor të KEDS-it.
11. Më 23 dhjetor 2015, punëdhënësi në bazë të Vendimit [Nr. 11040], e kishte shkëputur përfundimisht marrëdhënien e punës me parashtruesin e kërkesës, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës kishte bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës.
12. Më 28 dhjetor 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë tek punëdhënësi me kërkesë që të rishqyrtohet vendimi i lartpërmendur, duke pretenduar se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike, se është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës disiplinore dhe dispozitave ligjore dhe Rregullores së punëdhënësit.
13. Më 19 janar 2016, punëdhënësi përmes Vendimit [nr.561] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Vendimin [Nr. 11040], të 23 dhjetorit 2015, të punëdhënësit.
14. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Trupin Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, duke kërkuar që të anulohet Vendimi [Nr. 11040], i 23 dhjetorit 2015, me kërkesë që të kthehet në vendin e punës.
15. Më 22 mars 2016, Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës përmes Raportit Zyrtar lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera konstatoi se punëdhënësi kishte bërë shkelje ligjore me rastin e shkeljes së kontratës së punës.
16. Në një datë të paspecifikuar parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), duke kërkuar që të anulohet Vendimi [Nr. 11040], i 23 dhjetorit 2015, i punëdhënësit me kërkesë që të kthehet në vendin e punës si dhe kërkoj kompensim të të ardhurave personale duke filluar nga 23 dhjetori 2015 e deri më 30 nëntor 2016.
17. Më 7 shkurt 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr. 127/16] aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi si në vijim: I. Anuloi Vendimin [Nr. 11040] të 23 dhjetorit 2015, të punëdhënësit si të kundërligjshëm; II. Detyroi punëdhënësin që parashtruesin e kërkesës ta kthejë në vendin e njëjtë të punës apo në ndonjë vend tjetër që i përgjigjet kualifikimeve të tij; III. Detyroi punëdhënësin që parashtruesit të kërkesës, t'ia kompensojë të ardhurat personale për periudhën e kërkuar; IV. Të paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës; dhe V. Të paguajë të gjitha detyrimet për parashtruesin e kërkesës në Trustin Pensional të Kosovës.
18. Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj ndër të tjera shtoi "*Gjykata pas administrimit të provave prezente në lëndë, erdhi në përfundim se vendimi i të paditurës me të cilin paditësit i është shqiptuar masa disiplinore, largim nga puna, është marrë në mënyrë të kundërligjshme, është i padrejtë dhe në*

kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë, për arsye se masa disiplinore e pushimit të marrëdhënies së punës mund ti shqiptohet të punësuarit sipas procedurës në mënyrën dhe rrethanat e parashikuara me ligj, akte normative dhe kontratë kolektive[...] Në rastin konkret vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë me shkeljen e procedurës së paraparë me dispozitat e cekura më lartë, për arsye se paditësi [Parashtruesi i kërkesës] i ka realizuar të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, te e paditura dhe me asnjë provë të vetme nuk janë argumentuar shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, për të cilat pretendon e paditura, për arsye se procedura për konstatimin e përgjegjësisë së punëtorit për shkeljen e detyrave të punës, duhet të iniciohet dhe të përfundoj procedura disiplinore në afatet e parapara ligjore dhe duke respektuar të gjitha të drejtat e punëtorit”.

19. Në një datë të paspecifikuar, punëdhënësi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kundër aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 2 korrik 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AC.NR.1597/17] refuzoi si të pathemeltë ankesën e punëdhënësit, dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.127/16] të Gjykatës Themelore në Pejë, duke e vlerësuar qëndrimin e kësaj të fundit si të drejtë dhe të bazuar në argumente ligjore.
21. Më 30 gusht 2019, punëdhënësi kishte paraqitur kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, kundër dy aktgjykimeve të lartpërmendura, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 30 janar 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.457/2019], pranoi pjesërisht si të bazuar revizionin, duke vendosur si në vijim: I. Refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për kthim në vendin e punës, II. Prishi Aktgjykimin [C.nr.127/16] e Gjykatës Themelore, duke kthyer në rigjykim pjesën lidhur me pikën III, IV dhe V të dispozitivit të këtij të fundit; dhe III. Refuzoi si të pabazuar revizionin e punëdhënësit për anulimin si të kundërligjshëm të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore lidhur me Vendimit [nr.11040], të datës 23 dhjetor 2015, të punëdhënësit.
23. Më tutje në Aktgjykimin e saj Gjykata Supreme, arsyetoi se duke u mbështetur në nenin 67 të Ligjit të Punës, parashihet se marrëdhënia e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kontratës, dhe se përtej kësaj në Ligjin e Punës nuk ka asnjë dispozitë e cila e mbështetë arsyetimin e dhënë në Aktgjykimin [C.nr. 127/16] e 7 shkurtit 2017, të Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat parashtruesit të garantuara me nenin 31 [E

Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutë.

25. Parashtruesi i kërkesë fillimisht thekson se ai nuk ka kryer asnjë shkelje të detyrave të punës, për çka i është ndërprerë marrëdhënia e punës, dhe se vendimi për shkëputjen e marrëdhënies së punës është në kundërshtim të plotë me nenin 73 të Ligjit të Punës.
26. Parashtruesi i kërkesë në thelb pretendon se “ çdo jurist e ka të qartë faktin se kur një Akt juridik ANULOHEM (siç është rasti me vendimin nr.11040 datë 23 dhjetor 2015, atëherë edhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga ai janë të pavlefshëm , andaj ne nuk dimë si ta komentojmë faktin se kur Vendimi mbi Shkëputjen e Kontratës së Punës së pari Anulohet e Kthimi në vend të punës nuk lejohet”.
27. Më tutje parashtruesi i kërkesës shton se “Kjo fare nuk mund të arsyetohet edhe nëse aludohet se ka patur arsye në bazë të kontratës në kohë të caktuar, sepse këto dilema tani janë hjekur sepse kontrata në kohë të caktuar është e përcaktuar me Ligjin e punës dhe me Kontratën Kolektive [...] Dispozitat e Nenit 10 të Kontratës Kolektive në pikën 5 parashofin se nëse kontrata e punës për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetkuptuar për një periudhë të punësimit më të gjatë se (3) vite do të konsiderohet si kontratë e Ligjshme në kohë të pacaktuar. Në rastin tonë kemi me kontratë të pa ndërprerë për më shumë se 6 vite”.
28. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Gjykata Supreme me rastin e vendosjes së këtij rasti ishte e anshme duke theksuar se “Konsiderojmë se Gjykata Supreme me rastin e vendosjes ishte e njëanshme dhe vendosi duke i cenuar (shkelur) përveç dispozitave të cekura më lartë edhe dy nga të drejtat Themelore të propozuesit [Parashtruesit të kërkesës] të cilat garantohen me Kushtetutën e republikës së Kosovës: të drejtën për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit pa analizuar fare se propozuesi pa kurrfarë baze ligjore ishte larguar nga puna, shkëputë kontrata e punës edhe pse ishte i vetmi mbajtës dhe ushqyes i familjes 6 anëtarëshe dhe me fajin e vetëm se ishte punëtor fizik”.
29. Parashtruesi i kërkesës kërkon që vendimi i kontestuar të vlerësohet si antikushtetues.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 5

Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

[...]

Neni 10
Kontrata e Punës

[...]

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 67
[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70
[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit

*duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.
[...]*

*Neni 73
Largimi i përkohshëm nga puna*

1. I punësuar mund të largohet përkohësisht nga puna, kur:

1.1. ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale;

1.2. i punësuar është në vuajtje të paraburgimit;

1.3. kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj.

*Neni 80
Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës*

1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njëri prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjukata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatojë vendimin e gjykatës kompetente.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjukata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjukata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

32. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afat]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

33. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

34. Megjithatë, Gjykata i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

35. Gjykata së pari vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të

- Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe neni 49 i Kushtetutës duke pretenduar se vendimi i kontestuar është kundërthënës.
36. Në thelb, parashtruesi i kërkesës e arsyeton kërkesën e tij në lidhje me aplikimin e gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, duke theksuar se aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i kundërligjshëm pasi:
- (i) sipas parashtruesit të kërkesës vendimi i kontestuar është kundërthënës, sepse sipas tij kur një akt juridik anulohet, ashtu siç përcaktohet në vendimin e kontestuar, specifikisht në pikën III të dispozitivit të këtij të fundit (siç është rasti me vendimin [nr.11040] e 23 dhjetorit 2015), atëherë edhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga ai janë të pavlefshme.
 - (ii) Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se vendimi i kontestuar është arbitrar për faktin se në të theksohet se parashtruesit të kërkesës i ka skaduar kontrata e punës duke shtuar se *“Dispozitat e Nenit 10 të Kontratës Kolektive në pikën 5 parashofin se nëse kontrata e punës për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetkuptuar për një periudhë të punësimit më të gjatë se (3) vite do të konsiderohet si kontratë e Ligjshme në kohë të pacaktuar. Në rastin tonë kemi me kontratë të pa ndërprerë për më shumë se 6 vite”*.
 - (iii) Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me revizion e punëdhënësit ishte e njëanshme.
37. Gjykata, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, do i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GEDNJ), e cila obligon Gjykatën që në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.
38. Së pari, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës i cili thekson se kur një akt juridik anulohet, ashtu siç përcaktohet në vendimin e kontestuar, specifikisht në pikën III të dispozitivit të këtij të fundit (siç është rasti me vendimin [nr.11040] e punëdhënësit, të 23 dhjetorit 2015), atëherë edhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga ai janë të pavlefshme.
39. Në ndërlidhje me këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, ku ndër të tjera arsyetoi se *“Kthimi në vendin e punës pas tejkalimit të afateve të kontratës është i pa mbështetur në ligj dhe si i tillë i paqëndrueshëm. Qartazi kontrata e punës e përkufizon aftain kohor deri më 7 maj 2016 dhe përtej kësaj nuk ka mjete ligjore në Ligjin e Punës dhe as në ndonjë dispozitë tjetër që e mbështesin këtë qëndrim të Gjykatës së shkallës së parë. Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se sipas dispozitës së nenit 80 par 1. Pika 1 të Ligjit të Punës e paditura ka obligim që paditësit t’ia paguaj pagat sipas kontratës së punës, me vendimmarrje gjyqësore por konstatimi i gjykatës së shkallës së parë se qëndron obligimi i të paditurës se paditësit t’ia paguaj pagat mujore në shumë prej 388.5 euro deri në kthimin në punë është i paqëndrueshëm, ngase paditësit i takojnë vetëm pagat e papaguara sipas kontratës së punës nr. 12623/4193 datë 1 shtator 2014 dhe të Aneksit të Kontratës së njëjte datë 16*

janar 2015 [...] Lidhur me pretendimet e revizionit se Vendimi i të paditurës është i ligjshëm sepse ishte iniciuar procedura disiplinore ne përputhje me ligjin Gjykata Supreme gjeti se qëndrimi i Gjykatës së Shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar ne Ligj. Procedura ishte iniciuar për shkelje te lehtë disiplinore dhe kishte përfunduar me mase adekuate për shkelje të rendë. Pohimi i te paditurës se i padituri ka qene jashtë punëve dhe detyrave me lejen e eprorit te vet e bëjnë te pa qëndrueshëm pretendimin e revizionit se Gjykata ka nxjerr aktgjykim në pjesën që ka te bëjë me anulimin e vendimit të të paditurës në shkelje te dispozitave të ligjit procedural dhe te drejtës material. Është i drejte dhe i bazuar ne ligj qëndrimi i Gjykatës se vendimi për shkëputjen e kontratës për shkaqet e dhëna ne arsyetim duhej anuluar. Për me tepër ne provat e administruara dhe ne konstatimin e Trupës ekzekutive te Inspektoratit te Punës te Kosovës del se nuk është konstatuar shkelja e dispozitave te Ligjit te punës e as akteve normative te KEDS-it. Procedura është zbatuar ne papajtueshmëri me ligjin dhe pretendimet e revizionit janë marr në konsiderim dhe si te tilla përsëriten edhe në këtë fazë te procedurës. Prandaj revizioni në këtë pjese refuzohet si i pa bazuar”.

40. Në ndërlidhje me këtë që u tha më lart, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës që ai kishte kontratë të vlefshme me punëdhënësin deri më 30 nëntor 2016, dhe sipas nenit 67 të Ligjit të Punës përcaktohet qartë se marrëdhënia e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj, në ndërlidhje me rastin para nesh, theksoi se Kontrata e punës si instrument i realizimit te marrëdhënies së punës ka skaduar, kthimi ne punë është bërë i porealizueshëm, për faktin se ka skaduar kontrata e punës, ndërsa pretendimin e punëdhënësit se Vendimi [Nr. 11040]i punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës ishte i drejtë, Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar dhe në këtë pikë konsideroi se arsyetimet e vendimeve të gjykatave të shkallëve më të ulëta ishte i drejtë dhe i bazuar në ligj.
41. Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin [Rev.nr.457/2019] e 30 janarit 2020, të Gjykatës Supreme me të cilin është pranuar revizioni i punëdhënësit, është i qartë sa i përket çështjes së ngritur nga parashtruesi i kërkesës për kthimin e tij në vendin e punës dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Gjykatës Supreme dhe gjykatave të instancave më të ulëta, nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituaniës*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
42. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqesë argumente dhe dëshmi që ai i konsideron të rëndësishme për rastin e tij; se atij i është dhënë mundësia që të kontestojë në mënyrë efektive argumentet dhe dëshmitë e paraqitura nga pala kundërshtare; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shtruar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës Nr. KI118/17, *Parashtrues Sani Kervan dhe të*

tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29).

43. Së dyti, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, se në rastin para nesh Gjykata Supreme, është dashur të aplikojë nenin 10 të Kontratës Kolektive, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e parashtruesit të kërkesës i cili ndër të tjera thekson se Gjykata Supreme në rastin e tij është deshtë të merr parasysh nenin 10.5 të Kontratës Kolektive, i cili parasheh se nëse kontrata e punës për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptuar për një periudhë të punësimit më të gjatë se (3) vite do të konsiderohet si kontratë e ligjshme në kohë të pacaktuar, dhe se në rastin e parashtruesit, ky i fundit kishte kontratë të pa ndërprerë për më shumë se (6) vite.
44. Në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, Gjykata thekson se të njëjtat në esencë ndërlidhen me zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga Gjykata Supreme, pretendime të cilat, Gjykata në përputhje me praktikën e saj gjyqësore dhe atë të GJEDNJ-së, i konsideron si "*pretendime të shkallës së katërt*".
45. Në kontekst të kësaj kategorie pretendimesh, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtruese *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).
46. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
47. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen

përfundime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përfundim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “*aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GJEDNJ-së për nenin 6 të KEDNJ-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e Mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

48. Në këtë kontest, Gjykata rikujton që në rrethanat e rastit konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit së kërkesës ndërlidhen me pretendimin se Gjykata Supreme nuk e kishte zbatuar nenin 10 të Kontratës Kolektive.
49. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, kishte sqaruar parashtruesit se “*Në këso rrethanash kur Kontrata e Punës si instrument i realizimit të marrëdhënies së punës ka skaduar kthimi në punë është bërë i perealizueshëm, për faktin se ka skaduar kontrata e punës*”.
50. Gjykata konstaton se Gjykata Supreme në mënyrë të qartë thekson se në bazë të nenit 67 al. 1 pika 3 të Ligjit të Punës parashihet se marrëdhënia e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kohëzgjatjes së punës.
51. Në rrethana të tilla, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta të shtjelluara më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj se gjykatat e rregullta mund të kenë “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*”, duke rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesit e kërkesës, dhe rrjedhimisht pretendimet e saj për interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “*ligjshmërisë*” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “*kushtetutshmërisë*”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
52. Gjykata, në fund lidhur me këtë pretendim, gjithashtu thekson se pakënaqësia e parashtruesit së kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e

GJEDNJ-së, *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21)

53. Së treti, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme me rastin e vendosjes lidhur me revizionin e punëdhënësit kishte qenë e njëanshme, Gjykata rikujton edhe një herë pretendimin e parashtruesit të kërkesës se *“Gjykata Supreme me rastin e vendosjes ishte e njëanshme dhe vendosi duke i cenuar (shkelur) përveç dispozitave të cekura më lartë edhe dy nga të drejtat Themelore të propozuesit [Parashtruesit të kërkesës] të cilat garantohen me Kushtetutën e republikës së Kosovës: të drejtën për Gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për punë dhe ushtrim të profesionit pa analizuar fare se propozuesi pa kurrfarë baze ligjore ishte larguar nga puna, shkëputë kontrata e punës edhe pse ishte i vetmi mbajtës dhe ushqyes i familjes 6 anëtarëshe dhe me fajin e vetëm se ishte punëtor fizik”*.
54. Gjykata vëren se këtë pretendim parashtruesi i kërkesës përveç që e ka përmendur si fakt, nuk e ka elaboruar më tutje se si Gjykata Supreme gjatë vendosjes së rastit kishte qenë e anshme, për më tepër, pse ky fakt ka shkaktuar shkelje kushtetuese. Parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me asnjë argument këtë pretendim të tij.
55. Prandaj, Gjykata vlerëson se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës refuzohet si i pambështetur dhe rrjedhimisht i pabazuar.
56. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon se është viktimë e një veprimi të padrejtë ose arbitrar të një autoriteti publik, që ka rezultuar në cenimin e të drejtës së tij të mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës, përkatësisht të drejtës së punës dhe ushtrimit të profesionit, apo ndonjë të drejte tjetër kushtetuese.
57. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Vendimi i 30 qershorit 2009).
58. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

